
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p> <p style="color: blue; font-size: 1.2em;">01-2942</p>	<p>PRISHTINA</p> 
---	--	--

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe duke vendosur sipas kërkesës së Mujë Gashi-t nga Prishtina 05 nr. 350/02-0273929/3/18 dt. 11.09.2018, për rihapjen e procedurës së lëndës 05/350-02-0273929/17 dt. 06.11.2017, për caktimin e kushteve ndërtimore për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa afariste me karakter të përkohshëm dhe me destinim-përmbajtje: Pikë e shitjes së derivateve të naftës dhe market, në Çagllavicë, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 29.10.2018, cakton këto:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I CAKTOHEN kërkuesit Mujë Gashi nga Prishtina, sipas kërkesës 05 nr. 350/02-0273929/3/18 dt. 11.09.2018, për rihapjen e procedurës së lëndës 05 nr. 350/02-0273929/17 dt. 06.11.2017, kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa afariste me karakter të përkohshëm dhe me destinim - përmbajtje: Pikë e shitjes së derivateve të naftës, "Fast Food" & market, me etazhitet P+0, në kuadër të pjesës së parcelës kadastrale nr. 728-14 ZK Çagllavicë.

II. Lokacioni, për të cilën caktohen këto kushte ndërtimore, gjendet në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal në Prishtinë, miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, 01. nr. 031-156871, më 27.08.2013, ku sipas këtij plani, parcela kadastrale nr. 728-14 ZK Çagllavicë, është e destinuar për ndërtim. Kushtet ndërtimore për ndërtimin e ndërtesave të lartcekura caktohen bazuar në “Rregulloren për procedurën e ndërtimit të ndërtesave, me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik”, miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, 01 nr. 110-288305 dt. 31.12.2014.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale nr. 728-14 ZK Çagllavicë, është:

- Sipërfaqja e parcelës kadastrale nr. 728-14 ZK Çagllavicë është $S=1001m^2$ dhe me pronar: Mujë Gashi nga Prishtina;
- Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 728-14 ZK Çagllavicë, nuk ka të ndërtuar ndërtesë;
- Qasja në kompleks është përmes magjistrales Prishtinë – Gjilan;
- Tereni është relativisht i rrafshët, dhe kota e nivelit të rrugës është e ngritur ~300cm nga niveli i truallit;

IV. Kushtet ndërtimore për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar, bazuar në kriteret e rregullores dhe parametrat urban për realizimin - ndërtimin e kompleksit me ndërtesa afariste me karakter të përkohshëm dhe me destinim - përmbajtje: Pikë e shitjes së derivateve të naftës, "Fast Food" & market, auto larje dhe hapësira tjera përcjellëse, janë:

- Gabariti, pozita, organizimi, etazhiteti i ndërtesave, kyçja e kompleksit në komunikacion, raporti i ndërtesave me vijën rregulluese dhe ndërtimore, rrugët e planifikuara të kompleksit si dhe kushtet tjera, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në planin e lokacionit – “zgjidhja urbane”, bashkangjitur këtij Vendimi;
- Qasja, hyrja - dalja në kompleks, të bëhet nga magjistralla Prishtinë-Gjilan, duke i respektuar rregullat teknike për kyçje të parapara sipas Vendimit të Ministrisë së Infrastrukturës nr. 6124 dt. 26.06.2018;
- Shfrytëzimi maksimal për ndërtim i parcelës kadastrale, në sipërfaqe prej $1001m^2$, mund të jetë max.40%, gjegjësisht $1001 \times 0.4=400.4m^2$ (sipas projekt propozimit është $S=384m^2$);

- Sipërfaqja e ndërtesave të planifikuara, sipas projekt propozimit janë: "marketi" me zyra dhe nyje sanitare, është me sipërfaqe prej $S=46.6m^2$, Strehë - Pikë e shitjes së derivateve të naftës, është me sipërfaqe totale $S=338m^2$;
- Etazhiteti i ndërtesave me përmbajtje: market, me zyrat e personelit dhe nyjat sanitare, të jetë P+0, me lartësi maksimale $4.7m'$ (sipas projekt propozimit);
- Etazhiteti i ndërtesës të strehës-pikë e shitjes së derivateve të naftës, të jetë gjithashtu P+0 dhe me lartësi maksimale $H=4.7m'$, gjegjësisht me lartësi të mjaftueshme për qasjen e makinerisë për furnizim me karburante (sipas projekt propozimit);
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesave të përkohshme, në kuadër të kompleksit, të jetë për afarizëm, përkatësisht Pikë e shitjes së derivateve të naftës, market për dhe furnizime të konsumatorëve;
- Kuota e nivelit të përdhese së ndërtesës nga niveli i terrenit – pllatos ose trotuarit, mund të jetë max. 30 cm;
- Ndërtesat me karakter të përkohshëm lejohen të ndërtohen nga materialet montuese dhe lehtë demontuese, si: hekuri, druri, plastika apo edhe ndonjë material i ngjashëm, dhe nuk lejohen elementet muratore dhe nga betoni për ndërtimin e ndërtesave (projekt propozimi është nga konstruksioni i hekurit);
- Bazamenti i ndërtesave – themelet, mund të jenë nga betoni i armuar;
- Në ndërtesa nuk lejohet ndërtimi i etazheve nëntokësore;
- Distanca e ndërtesave nga kufiri i parcelës fqinje mund të jetë deri në 120 cm, me pëlqim të pronarëve të parcelave fqinje, kurse nëse në parcelat fqinje ndodhen ndërtesat ekonomike, distanca mund të eliminohet me pëlqimin e pronarëve, ndërsa sipas Planit Zhvillimor Komunal distanca minimale nga kufiri i parcelës është $0.5 H$, ku H është lartësia e ndërtesave;
- Në kuadër të kompleksit të planifikohen edhe sipërfaqet gjelbëruese, me gjelbërim të lartë dhe të ultë, hapësira të organizuara për rekreacion të vizitorëve të kompleksit, dhe atë min.20%, ose $1001 \times 0.2=200.2m^2$, (sipas projekt propozimit kjo sipërfaqe është $S=223.30m^2$);
- Në kuadër të kompleksit të planifikohen edhe rrugë qarkulluese, për qasje të zjarrfikësve si dhe shtigje, sipërfaqe të pllakëzuara dhe vend-parkime të mjaftueshme për personel dhe klientë;
- Në kuadër të kompleksit të parashihet edhe vendosja e rezervuarëve metalik të izoluar për deponimin e derivateve të naftës (4 copë), të cilët planifikohen të vendosen në vend të përshtatshëm, nën tokë – në dhe, ku në hapësirën e vendosjes nuk lejohet të ketë elemente nga betoni;
- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Gjatë punimeve ndërtimore duhet kujdes i veçantë në mbrojtjen e dobive natyrore.

V. Kushtet e veçanta – për aplikim për leje ndërtimore, duhet të sigurohen:

- Pëlqimin Mjedisor - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, i lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Pëlqimin në lokacion, mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri për ndërtimin e ndërtesave me karakter të përkohshëm me destinim: Pikë e shitjes së derivateve të naftës dhe market, lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme - Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave;
- Licencën e kompanisë për zhvillimin e biznesit për pikat për furnizimin e automjeteve me derivate;

VII. Deklarata e noterizuar nga investitori / qiramarrësi, duhet të prezantohet me dokumentacionin ndërtimor për aplikim për leje ndërtimore, se ndërtesa është me karakter të përkohshëm, se nuk do të jetë pengesë për realizimin- zbatimin e planit urban për atë zonë, dhe se investitori / qiramarrësi, ndërtesën do ta largojë në afat prej 8 ditëve.

VIII. Kycja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kycje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ajroincizimi - ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese ;
- Përshkrimin teknik të ndërtesës (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohitorja e Qytetit.

IX. Hartimi i dokumentacionit ndërtimor-projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV. dhe V., projekt propozimin e prezantuar, normat dhe standardet në fuqi për këto lloje të ndërtesave, dhe të jenë në harmoni me rregullativën ligjore në fuqi:

- a). Udhëzimin Administrativ Nr. 2007/18 për kërkesat teknike për ndërtimin dhe funksionimin e pikave për furnizimin e automjeteve me karburante;
 - b). Udhëzimin Administrativ Nr. 09/2010 për përmbushjen e kushteve teknike për subjektet që merren me importin, deponimin, shitjen me shumicë dhe pakicë të karburanteve;
 - c). Udhëzimin Administrativ Nr. 23/2012 – MPB për normat teknike për furnizimin e mjeteve motorike me derivate të naftës, deponimin dhe toçitjen e derivateve të naftës në pikat e shitjes me pakicë;
 - d). Rregulloren Nr. 25/2012 për normat teknike të mbrojtjes nga zjarri në ndërtimin e impianteve për lëngjet e ndezshme, deponimin dhe toçitjen e tyre;
 - e). Udhëzimin Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të ndërtesave, ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara.
- dhe duhet të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
 - Situacionin - Planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
 - Situacionin - Planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë, relative dhe absolute;
 - Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
 - Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
 - Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
 - Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare;
 - Detajet e nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
 - Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiluarin urban, etj;
 - Projektin e strukturës së ndërtimit-llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detaje e nevojshme;
 - Projektin e instalimeve elektro-energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
 - Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
 - Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
 - Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01nr.035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
 - Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
 - Elaboratin gjeomekanik, në bazë të analizave të terrenit;
- X. Vlefshmëria** e kushteve ndërtimore është një (1) vit, duke llogaritur nga dita e lëshimit, kurse procedura e ndryshimit dhe plotësimit të tyre të bëhet me kërkesë të pronarëve ose investitorit, në procedurën e njëjtë e të paraparë për lëshimin e tyre.

A r s y e t i m

Kërkuesi Mujë Gashi nga Prishtina, me kërkesën për rihapjen e procedurës së lëndës 05 nr. 350/02-0273929/3/18 dt. 11.09.2018, për caktimin e kushteve ndërtimore 05/350-02-0273929/17 dt. 06.11.2017, kanë kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për lejimin e ndërtimit të ndërtesës – pikë e furnizimit me derivate, në lokacionin e përshkruar në dispozitiv të këtij Vendimi.

Bashkangjitur me kërkesë është prezantuar dokumentacioni si në vijim:

- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale për parcelën kadastrale nr. 782-14 Zona Kadastrale Çagllavicë, të vërtetuar te noterja Valdete I. Ademi me LRP.Nr. 2540/2017 dt. 30.08.2017;
- Kontratë për shitblerjen e tokës-parcelës, e lidhur në mes të Mujë Gashi nga Prishtina dhe Naser Sadiku nga Vitia, për parcelën kadastrale nr. 782-14 ZK Çagllavicë, të vërtetuar te noterja Valdete I. Ademi me LRP.Nr. 2540/2017 dt. 30.08.2017;
- Fotokopjen e pa vërtetuar të certifikatës së regjistrimit të biznesit të kompanisë “Albapetrol Group” sh.p.k., me numër 71354598;
- Informatën nga Plani Zhvillimor Komunal, të lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm me nr. 1050 dt. 04.10.2017 (përmes sistemit online);
- Incizimin gjeodezik të parcelës kadastrale, të punuar nga gjeodeti i licencuar Feriz Sinani, me numër të licencës 53, dhe datë të skadimit 06.12.2017.
- Projektin konceptual – zgjidhja urbane e punuar nga kompania projektuese “Sigma Contruccion” sh.p.k., me certifikatë të regjistrimit të biznesit me nr. 70838079, me bartës të projektit Arbnore Aliçkaj, i.d.a;
- Vendimin nr. 6124 dt. 26.06.2018, e lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës me ane të cilit ipet pëlqimi për çasje në rrugën nacionale N25.2 (drejtimi Prishtinë-Gjilan);
- Fotokopjet e letërnjoftimit të Naser Sadiku-t;

Drejtoria e Urbanizmit pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për zonën në fjalë, rregullativën ligjore në fuqi si dhe pas hulumtimit të arkivit të kësaj drejtorie ka konstatuar se, për këtë çështje janë zhvilluar procedurat administrative si në vijim:

Kërkuesi Mujë Gashi nga Prishtina, me kërkesën 05 nr. 350/02-0273929/17 dt. 06.11.2017, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për lejimin e ndërtimit të ndërtesës së përkohshme – pikë e furnizimit me derivate, me etazhitet P+0, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal, në Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 728-14 Zona Kadastrale Çagllavicë. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar, kjo drejtori, me shkresën zyrtare me nr. 05-350/02-0273929/17 dt. 29.11.2017, ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit me pikat si në vijim:

1. Projekti konceptual:

- Të prezantohen llogaritjet e sipërfaqeve të strehës, ndërtesa dhe rezervuarve;
 - Të paraqitet dimenzionimi i plotë i situacioneve, dhe bazës së përdheses;
 - Të paraqitet kapaciteti i rezervuarve në situacione, dhe bazën e përdheses;
 - Rezervuarët duhet të spostohen nga kufiri i parcelave fqinje min. 1m’;
 - Projekt propozimi të dorëzohet edhe në verzionin digjital (dwg);
2. Po ashtu, situacioni i zgjidhjes urbane e paraparë për çasje të automjeteve për furnizim me karburante, duhet të lidhet me rrugën ekzistuese nacionale N25.2, si hyrja ashtu edhe dalja nga pika e shitjes së derivateve. Për aplikimin e kushteve dhe kritereve të çasjes me rrugën nacionale duhet ti referoheni Udhëzimit Administrativ (MI) nr. 09/2015 për kyçje, instalime për tokën rrugore dhe për shfrytëzimin të tokës së rrugëve nacionale dhe rajonale, ku një prej kushteve teknike është aplikimi i rrezes minimale prej $R=10m'$, e lidhjes së kyçjes me rrugën nacionale dhe anasjelltas.

Mujë Gashi nga Prishtina, me kërkesën me nr. 05-350/02-0273929/17/1 dt. 19.12.2017, i është drejtuar drejtorisë së urbanizmit të komunës së Prishtinës për plotësimin e dokumentacionit të lëndës nr. 05 nr.350/02-0273929/17 dt. 06.11.2017.

Kjo Drejtori, pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar, me shkresën zyrtare “Kërkesë”, i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës - Departamentit të Infrastrukturës Rrugore 05 nr. 350/02-0273929/17 dt. 15.03.2018, me pyetjen si në vijim, citoj:

Kjo drejtori pas shqyrtimit të kërkesës ka konstatuar se parcela e lartcekur bënë pjesë në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal, i miratuar me Vendimin 01.nr.031-156871 të dt. 27.08.2013 dhe sipas këtij plani dhe gjendjes faktike në terren, kjo parcelë tangjenton rrugën ekzistuese – Magjistralen Prishtinë - Gjilan.

Andaj, për vazhdimin e procedurës së vendosjes së kësaj çështjeje kërkojmë nga organi juaj që të na informoni për kriteret e ndërtimit, respektivisht distancën e vijës ndërtimore nga profili i kësaj rruge, si dhe të analizoni qasjen në pikën e furnizimit me derivate se a plotësohen kriteret ligjore për qasje sipas projektit konceptual të lokacionit të prezantuar në këtë drejtori.

Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve, me shkresën 05-016/01-0078855/18 dt. 04.04.2018, i është drejtuar kësaj drejtorie me “Njoftim lidhur me kërkesën nr. 2503, datë 21.03.2018, me përgjigjen si në vijim, citoj:

Distanca minimale e ndërtimit nga Rrugët Nacionale dhe Rajonale është e përcaktuar në bazë të Ligjit nr. 2003/11 për Rrugët dhe Ligjit me nr. 03/L-120 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rrugë me nr. 2003/11, si më poshtë:

Në afërsi të rrugës Nacionale N25.2 askush nuk mund të ndërtoj ndërtesa, rezidenca, zyre, puse, gropa septike, transmetues elektrik dhe instalime të ngjashme në distancë më të vogël se 20 metra, e matur nga skaji i jashtëm i brezit rrugor. Ndërsa, kushtet, rregullat dhe procedurat për marrjen e pëlqimit për ndërtimin e kyçjeve në rrugët Nacionale dhe Rajonale janë të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ (MI) nr. 09/2015 Për Kyçje, Instalime për Tokën Rrugore dhe për Shfrytëzim të Tokës së Rrugëve Nacionale dhe Rajonale si dhe Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 për Kyçje, Instalime nëpër Tokën Rrugore dhe për Shfrytëzim të Tokës Nacionale dhe Rajonale.

Pas pranimit të shkresës zyrtare nga Ministria e Infrastrukturës – Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve, është kërkuar mendimi profesional nga zyrtari përgjegjës për komunikacion i kësaj Drejtorie, dhe i njëjti me shkresën zyrtare të datës 25.04.2018, konstaton si në vijim, citoj:

Pas shikimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane për ndërtesën afariste P+0, pompë e derivateve, të Mujë Gashi nga Prishtina, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05 nr. 350/02-0283929/17 dt. 06.11.2017, situacioni i zgjidhjes urbane e paraparë për kyçje të automjeteve për furnizim me karburante, duhet të bëhet sipas kriterëve të Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2015 për kyçje instalime nëpër tokën rrugore dhe për shfrytëzim të tokës së rrugëve nacionale dhe rajonale, ku njëra prej kushteve teknike është aplikimi i rrezes minimale prej R-10m’, dhe shirit të hyrjes dhe daljes me gjerësinë e shiritit të rrugës nacionale. Funkzioni i hyrjes dhe daljes duhet të përshtatet me rrugën ekzistuese nacionale N25.2. Ministria e Infrastrukturës është kompetente për dhënien e pëlqimit për kyçje në rrugën nacionale N25.2 (Prishtinë-Gjilan), situacionin e aprovuar nga kjo Ministri duhet prezantuar në Drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, sipas së cilës do të ipet leja ndërtimore.

Pas pranimit të mendimit profesinal nga zyrtari përgjegjës për komunikacion i kësaj Drejtorie, me shkresën zyrtare “Informim-plotësim dokumentacioni” 05-350/02-0273929/17 dt. 25.04.2018, është kërkuar që të bëhet plotësimi i lëndës, gjegjësisht përmisimi i projektit konceptual të prezantuar, dhe i njëjti të punohet sipas të dhënave nga zyrtari përgjegjës për komunikacion i kësaj Drejtorie.

Mujë Gashi nga Prishtina, me shkresën zyrtare 05 nr. 350/02-0273929/2/17 dt. 08.05.2018, i është drejtuar kësaj Drejtorie për plotësimin e lëndës, duke prezantuar vetëm pjesën e situacionit të ngushtë të punuar nga kompania projektuese “Sigma Construction” sh.p.k., me bartëse të projektit Arbnore Aliçkaj i.d.a.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës dhe të dhënave të lartcekura, ka analizuar projektin konceptual të prezantuar nga kompania projektuese “Sigma Cotruction” sh.p.k., me ç ‘rast ka konstatuar se projekti konceptual nuk është punuar konform Udhëzimin Administrativ (MI) nr. 09/2015 Për Kyçje, Instalime për Tokën Rrugore dhe për Shfrytëzim të Tokës së Rrugëve Nacionale dhe Rajonale si dhe Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 për Kyçje, Instalime nëpër Tokën Rrugore dhe për Shfrytëzim të Tokës Nacionale dhe Rajonale, përkatësisht shiriti mbrojtës (shiriti gjelbërues) shtrihet në parcelën e cila është pjesë e Magjistrales N25.2 (Prishtinë-Gjilan), andaj, kërkesa si e tillë me Vendimin 05 Nr. 350/02-0273929/17 dt. 02.07.2018, është refuzuar.

Pronari Mujë Gashi nga Prishtina, me kërkesën 05-350/02-0273929/3/17 dt. 11.09.2018, i është drejtuar kësaj drejtorie me kërkesë për rihapjen e procedurës për lëndën 05/350-02-0273929/17 dt. 06.11.2017, për caktimin e kushteve ndërtimore, me ç' rast ka prezantuar Vendimin nr. 6124 dt. 26.06.2018, të Ministrisë së Infrastrukturës si dhe projektin konceptual me ndryshimet e kërkuara.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni - Planin Rregullues Komunal, rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, projektit konceptual - projektit ideor, me planin e situacionit - "zgjidhja urbane", ka konstatuar se:

Bazuar në konstatimet e më sipërme, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 7 dhe 8 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017, për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit - "zgjidhja urbane", i propozuar me projekt propozimin e ndërtesave, është në harmoni me destinimin e PZHK-ë për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, si dhe kjo drejtori me dt. 20.09.2018, ka vendos njoftimin publik, për lënien në dispozicion të publikut deri me datën 04.10.2018, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.


Shtojcë: Plani i situacionit -"zgjidhja urbane" e kompleksit me ndërtesa të planifikuara të pikës së furnizimit me derivate.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.


I dërgohet: Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në dosje të lëndës, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02-0273929/17 DT. 29.10.2018**

Zyrtari,
Zejnulla Rexhepi



U.D. Udhëheqëse e sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi



Drejtori,
Ardian Olluri

